



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

---

**BANKA E SHQIPËRISË**

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**

**Nr. Prot. 7949, datë 13.12.2007**

**Nr. Prot. 9323, datë 13.12.2007**

### MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ky memorandum lidhet ndërmjet palëve të mëposhtme:

**Bankës së Shqipërisë** (në vijim Banka), që është person juridik, publik i pavarur, që ka si objektiv arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve nga i cili kushtëzohen objektiva të tjerë të saj, që kanë për qëllim funksionimin normal të sistemit bankar, bazuar në parimet e tregut.

dhe

**Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës** (në vijim Ministria), që është organi më i lartë administrativ publik i arsimit.

---

Palët lidhin këtë memorandum duke mbajtur parasysh rëndësinë e transparencës dhe rritjes së shkallës së njohurive të publikut në përgjithësi dhe brezit të ri, në veçanti, mbi çështjet ekonomike dhe financiare, në funksion të përmbushjes së objektivit kryesor të Bankës.

Palët bien dakord si më poshtë:

#### **Neni 1 Objekti dhe qëllimi**

Objekti i këtij memorandum është përcaktimi i mënyrave të bashkëpunimit midis Bankës dhe Ministrisë me qëllim:

- a) nxitjen e bashkëpunimit reciprok në fushën e edukimit të nxënësve të shkollave nëntëvjeçare, të mesme si dhe studentëve të universiteteve në fushat e ekonomisë, financës dhe bankës; dhe
- b) përfitime të tjera reciproke në fushat me interes të përbashkët.

## **Neni 2 Baza ligjore**

Ky memorandum hartohet në bazë të paragrafit të parë të nenit 24, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar.

## **Neni 3 Detyrimet e palëve**

Palët marrin masat e nevojshme për të përmirësuar veprimtaritë në fushën e edukimit ekonomik dhe financiar, veçanërisht nëpërmjet veprimtarive të mëposhtme:

1. Institucionalizimit, sipas këtij memorandum dhe akteve të tjera të mëvonshme, të bashkëpunimit reciprok në fushën e edukimit ekonomiko-financiar për nxënësit e shkollave 9-vjeçare, të mesme dhe të studentëve të universiteteve në fushat e ekonomisë, financës dhe bankës, të qytetit të Tiranës.
2. Me mbështetjen e Ministrisë, Banka organizon katër seminare dyditore në vit për mësuesit e shkollave të mesme.
3. Me mbështetjen e Ministrisë, Banka organizon një trajnim vjetor për drejtorët e shkollave të mesme, për të ndihmuar në administrimin e decentralizuar të buxhetit të shkollave.
4. Me mbështetjen e Ministrisë, Banka organizon takime periodike të specialistëve të saj me nxënësit e shkollave të mesme, duke vizituar tre shkolla në muaj gjatë vitit shkollor.
5. Banka shpërndan periodikisht në shkollat e mesme broshurat dhe materialet e tjera me karakter edukativ, për të informuar brezin e ri mbi argumente nga fushat e ekonomisë, financës dhe bankës, të konceptuara në mënyrë të posaçme për ta.
6. Banka organizon vizita të drejtuara për nxënësit e shkollave nëntëvjeçare dhe të mesme në ambientet e brendshme të saj.
7. Në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe me mbështetjen e Ministrisë, Banka organizon aktivitetin vjetor "Dita e Bankës" me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave nëntëvjeçare dhe të mesme.
8. Banka organizon leksione të hapura me tematika nga fushat e ekonomisë, financës, bankës dhe më gjerë për studentët e Universitetit të Tiranës dhe universiteteve të tjera në rrethe.
9. Me mbështetjen e Ministrisë, Banka organizon një konkurs kombëtar për nxënësit e shkollave të mesme në fushën e bankingut.
10. Palët organizojnë aktivitete të përbashkëta si takime dhe/ose tryeza pune, me pjesëmarrjen e specialistëve të të dyja Palëve.

11. Palët publikojnë dhe/ose shkëmbejnë zyrtarisht të dhëna dhe informacione, në masën që përcaktojnë aktet juridike në fuqi, duke respektuar në rast nevojë karakterin e tyre konfidencial; dhe
12. Palët caktojnë një përfaqësues për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit që përcakton ky memorandum bashkëpunimi.

Ky memorandum nënshkruhet sot më datë 13.12.2007 dhe hyn në fuqi menjëherë.

**Për**

**Bankën e Shqipërisë**

**Ardian FULLANI**

-----

**GUVERNATOR**

**Për**

**Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës**

**Genc POLLO**

-----

**MINISTËR**